

KLSH merr pjesë në seminarin mbi Auditimin e Përputhshmërisë të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës

Në datën 11 tetor 2023, në Prishtinë u mbajt seminari mbi “Auditimet e Përputhshmërisë” i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës me mbështetjen e SIGMA-s në kuadër të Rrjetit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Seminari u mbajt në kuadër të 20-vjetorit të krijimit të ZKA-së.

Seminari mbledhi përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga vendet anëtare të Rrjetit, si: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe përfaqësues të SIGMA-së, të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe asaj të Kosovës.

Përfaqësuesit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ishin audituesit, z. Aldo Kume dhe z. Erald Kojku.



Hapjen e seminarit e bëri Auditorja e Përgjithshme e Kosovës, znj. Vlora Spanca, e cila falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen duke thënë se mbajtja e këtij seminari është me interes të veçantë për vendet tona dhe ka për qëllim shkëmbimin e përvojave të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe avancimin e metodologjisë në fushën e auditimit të përputhshmërisë.

Në përputhje me Planin e Punës të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të Vendeve Kandidate dhe Kandidate Potenciale për anëtarësim në BE dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve për periudhën 2022-2025, ky seminar mbi “Auditimin e Përputhshmërisë” ofroi

një mundësi për të shkëmbyer përvojat në të gjithë Rrjetin, për të diskutuar problemet, sfidat, mënyrat që janë gjetur për t'i menaxhuar ato si dhe ndarjen e përvojave mes vendeve anëtare të BE-së. Një objektivi tjetër i seminarit ishte që t'i bëjë një vlerësim praktikave të auditimit të përputhshmërisë në të gjithë Rrjetin si dhe t'i identifikojë sfidat e mbetura që Rrjeti mund t'i trajtojë së bashku në aktivitetet e ardhshme.

Pjesëmarrësit në tryezë u ftuan që të marrin pjesë aktive në diskutime gjatë seminarit për t'i ndarë përvojat e tyre praktike, por edhe për të shtruar pyetje dhe kërkesat e tyre në lidhje me Auditimet e Përputhshmërisë.

